



**AKTI I THEMELIMIT TE  
SHOQERISE ME PERGJGJESI TE KUFIZUAR  
"AMBER - VILLAGE 2022" SH.P.K**

Themeluesit e Shoqerise qe nenshkruan me poshte:

- **AMER ZIKO**, i biri i Ylli-it, lindur me date 04/10/1995 ne Tirane, Alb, banues ne njesine administrative nr.4, rruga "Myslym Keta", ne Tirane, i identifikuar me leternjoftim ID.033667918 dhe nr.personal J51004066L;
- **HYSEN KADIU**, i biri i Qazim-it, lindur me date 14/10/1987 ne Kavaje, Alb dhe banues ne Kavajë, lagje nr.6, Rruga "Skuraj", i identifikuar me leternjoftim ID.034741604 dhe nr.personal I71014074H.

**Kreu I**

**Te Dhenat mbi Shoqërin Tregtare**

**Neni 1**

Ne Kavaje, sot, me date **27/prill/2022**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe te plote, ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te hartojne kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar; **"AMBER - VILLAGE 2022" shpk**, me Administrator te vetem **ENES MERKJA**.

Ne baze te kushteve qe vijojne:

**Adresa e shoqerise:** Fshatin Spille, zona kadastrale nr.3501, pasuria nr.65/34-ND, Bashkia Rrogozhine.

**Objekti i Veprimtarise:** Hoteleri - turizem, bar restaurant, fast-food, pastrim kimik per hoteleri. Dhenia me qira e banesave clhe vendosja e shezlloneve ne bregdet. Agjensi udhetimi clhe akomodimi ne fushen e turizmit. Aktivitete ne fushen e ndertimit, ndertim objektesh civile dhe publike, vepra arti, rruge etj, njeje betoni, prodhim inertesh, tregtim me shumice dhe pakice te lendeve te ndryshme qe sherbejne ne ndertim si, hekur, cimento, llac i pergatitur etj. Shitje, blerje, dhenie apo marje me qira te pasurive te paluajtshme dhe veprime te tjera me to, projektim, ndertim, riparim, restaurim dhe veprime te tjera ndertimore te pasurive te paluajtshme qe jane ne pronesi te kesaj shoqerie apo personave te trete, supervizim projektesh ndertimi te te gjitha llojeve, duke perfshire cdo punim perberes te ndertimeve, administrim i ambienteve dhe godinave publike e private, kryerjen e investimeve ne te gjitha fushat. Import-eksport i materialeve dhe artikuj te ndryshem per sektorin e ndertimit dhe te hoteleri turizem, amballazhim, import eksport i brendshem dhe i jashtem si dhe cdo sherbim tjeter qe lidhet me veprimtarite e sipercituara, etj, Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 te Ligjit nr.990 1 ,dt.14.04-08).

**Selia e Shoqerise:** Fshatin Spille, zona kadastrale nr.3501, pasuria nr.65/34-ND, Bashkia Rrogozhine.

**Neni 2**

**Objekti**

- Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar): Hoteleri - turizem, bar restaurant, fast-food, pastrim kimik per hoteleri. Dhenia me qira e banesave clhe vendosja e shezlloneve ne bregdet. Agjensi udhetimi clhe akomodimi ne fushen e turizmit. Aktivitete ne fushen e ndertimit, ndertim objektesh civile dhe publike, vepra arti,



rruge etj, nyje betoni ,prodhim inertesh, tregtim me shumice dhe pakice te lendeve te ndryshme qe sherbejne ne ndertim si, hekur,cimento, llac i pergatitur etj. Shitje, blerje, dhenie apo marje me qira te pasurive te paluajtshme dhe veprime te tjera me to, projektim, ndertim, riparim, restaurim dhe veprime te tjera ndertimore te pasurive te paluajtshme qe jane ne pronesi te kesaj shoqerie apo personave te trete, supervizim projektesh ndertimi te te gjitha llojeve, duke perfshire cdo punim perberes te ndertimeve, administrim i ambienteve dhe godinave publike e private, kryerjen e investimeve ne te gjitha fushat. Import-eksport i materialeve dhe artikuj te ndryshem per sektorin e ndertimit dhe te hoteleri turizem, amballazhim, import eksport i brendshem dhe i jashtem si dhe cdo sherbim tjetër qe lidhet me veprimtarite e sipercituara, etj, Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndaloher me ligj (sipas nenit 7 te Ligjit nr.990 1 ,dt.14.04-08).

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

- Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë **e pa percaktuar** (vetëm nëse është e përcaktuar):

**Neni 4**  
**Selia**

- Fshatin Spille, zona kadastrale nr.3501, pasuria nr.65/34-ND, Bashkia Rrogozhine.
- Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është (nëse ka):
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

**Kreu II**  
**Kapitali**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **60.000 Euro** (dyzet e pesmije Euro) ose **7.200.000 leke** (shtatmiljon e dyqind mije leke) dhe ne natyre me prone te paluajtshme, pasuria nr.66/60, siperfaqe totale 4055 m<sup>2</sup>, me adrese ne spille, zona kadastrale 3501, regjistruar ne Ashk-Kavaje ne volumin 15, faqe 87 (sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtme:
- Ortaket themelues **AMER ZIKO**, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **30.000 Euro** (tridhjet mije euro), që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
- Ortaket themelues **HYSEN KADIU**, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **30.000 Euro** (tridhjet mije euro), që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

- Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

- Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



### **Neni 7** **Transferimi i kapitalit**

- Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8** **Organi Vendimmarres**

- Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.
- Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, mund të bëjë përfaqësimin dhe me videocall.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

- Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

- Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

- Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje tjera si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve;
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - h) Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### **Neni 12**

#### **Përfshirja nga e drejta e votës**

- Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes në se asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13 Administrimi

- Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5-vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje, emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

(emer, mbiemer, adresa):  
specimenët e nënshkrimit:

- **ENES MERKJA**, i biri i Ismet-it, lindur me date 18/08/1987 ne Tirane, banues ne Kavajë, lagjen nr.3, Rruga "Skuraj", i identifikuar me leternjoftim nr.personal **I70818122E**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

### Neni 14 Kompetencat e Administratorit

- Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5-(pese) % të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5-(pese) % të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
  - d) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

- e) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15**

#### **Pergjegjesite e Administratorit**

- Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.
- Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**Viti financiar-ekspertet**

**Neni 16**

- Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**  
**Ekspertet**

- Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja - riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**


- Shperndarja ose prishja e shoqërise mund te behet ne cdo kohe:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
  - b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
  - d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
  - e) me vendim te gjykatës;
- Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
- Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emërimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- Shoqëria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblesë se Ortakëve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesën IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

- Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



- Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

- Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


**O R T A K E T**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**\* EMERTIMI I SHOQËRISË\***


**"AMBER - VILLAGE 2022" SH.P.K**

Themeluesit e Shoqerise qe nenshkruan me poshte:

**AMER ZIKO**

AMER ZIKO 

**HYSEN KADIU**

Hyse Kadriu 



RËPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER ARBËR ALIU

DATE 27/04/2022  
NR REP 3227



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Ne Kavaje, sot, më datë 27/Prill/2021, para meje noterit ARBËR I. ALIU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Durrës, mbajtes i licenses nr.500, me zyrë në adresën Kavaje, lagje nr.4, Shtetitorja "Indrit Cara", Godina nr.270, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUESI:** AMER ZIKO, i biri i Ylli-it, lindur me date 04/10/1995 ne Tirane, Alb, banues ne njesine administrative nr.4, rruga "Myslym Keta", ne Tirane, i identifikuar me leternjoftim ID.033667918 dhe nr.personal J51004066L;

**NËNSHKRUESI:** HYSEN KADIU, i biri i Qazim-it, lindur me date 14/10/1987 ne Kavaje, Alb dhe banues ne Kavajë, lagje nr.6, Rruga "Skuraj", i identifikuar me leternjoftim ID.034741604 dhe nr.personal I71014074H.

AMER ZIKO dhe HYSEN KADIU, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, "Akt Themelimi AMBER-VILLAGE 2022" shpk dokumenti bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr.110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NËNSHKRUESIT**

AMER ZIKO  
Hysen Kadu

**NOTER**

**ARBËR I. ALIU**

Arbër Aliu